

**NOMENKLATURA**

**E**

**VEPRIMTARIVE**

**EKONOMIKE**

**REV.1.1**

**2001**

**Përmbajtje****Faqe**

1. Parathënie.....	3
2. Akte ligjore.....	15
3. Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike – Struktura .....	19
4. Detajime në nivel kombëtar.....	51

**PJESA E PARE  
PARATHENIE  
E  
NVE REV.1.1**

## **I Informacion i Përgjithshëm**

### **I.a Parathënie**

Një nga kërkesat bazë në statistikë është ekzistenca e një strukture në përgjithësi të miratuar tek e cila mund të hyjë një gamë e gjerë të dhënash statistikore të disponueshme, në mënyrë që ato të mund të paraqiten dhe analizohen në mënyrë domethënëse. Sistemet e klasifikimit japin një gjuhë të përbashkët për përpilimin dhe paraqitjen e statistikave.

Ndër vite, vendet kanë zhvilluar klasifikimet e tyre ose kanë përdorur sistemet ndërkombëtare të klasifikimit për të plotësuar nevojat e tyre. Rezultat i kësaj pune të pakoordinuar është se seritë e sistemeve kombëtare, megjithëse mund të plotësojnë nevojat kombëtare, ato janë të plota të bëjnë krahasime ndërkombëtare, janë vetëm për operimin e një tregu të thjeshtë.

Për një treg unik dhe efektiv, për analiza mikro dhe makro ekonomike dhe për marketingun komercial, është e domosdoshme të ketë një sistem klasifikimi të thjeshtë, që të mund të përdoret në të gjithë shtetet anëtare të Bashkimit Europian.

Sistemet e statistikave për të plotësuar nevoja të ndryshme ekonomike, kërkojnë klasifikime të ndryshme. Klasifikimet ndërkombëtare janë ndërtuar për të plotësuar çdo nevojë. Kjo shtrirje nga sektori i klasifikimeve është mishëruar në Sistemin e Llogarive Kombëtare (SNA), Klasifikimi Industrial Standart Ndërkombëtar i të gjitha Aktiviteteve Ekonomike (ISIC) dhe klasifikimi shumë i detajuar i mallrave në Sistemin e Harmonizuar (HS).

Një *klasifikim i aktiviteteve ekonomike* është konceptuar për të kategorizuar të dhënat që mund të jenë të lidhura me njësinë e aktivitetit, për shembull të një fabrike individuale ose grup fabrikash që përbëjnë të njëjtën njësi ekonomike p.sh një ndërmarrje. Kjo siguron bazën për përgatitjen e statistikave të prodhimit, elementëve hyrës në procesin e prodhimit (si puna, materialet, energjia, etj), e formimit të kapitalit dhe transaksionet financiare të disa njësive.

Një *klasifikim i produkteve* është përcaktuar për kategorizimin e produkteve (mallrave dhe shërbimeve) që kanë karakteristika të përbashkëta. Ato sigurojnë bazën për përgatitjen e statistikave të prodhimit, tregtisë, konsumit, tregtisë së jashtme dhe transportit të këtyre produkteve.

### **I.b Klasifikimi evropian i aktiviteteve ekonomike**

Shumë vende të komunitetit duke punuar me klasifikimet e aktiviteteve të cilat te përshtatura me kriteret kombëtare specifike, kishin vështirësi të konsiderueshme për të prodhuar të dhëna për aktivitete të krahasueshme ndërmjet vendeve të ndryshme.

Bazuar sa më sipër është arritur në një marrëveshje të përgjithshme që të dhënat e krahasueshme mbi aktivitetet për të gjitha shtetet anëtare është esenciale dhe që këto mund të prodhohen vetëm në qoftëse ka një klasifikim të harmonizuar. Marrëveshja mundësoi të ndërtohej një klasifikim i aktiviteteve ekonomike të Komunitetit e cila mund të shërbejë si bazë për grumbullimin dhe prezantimin e statistikave të lidhura me aktivitetin për të plotësuar nevojat e paraqitura në paragrafin.

Sistemet e klasifikimit janë rishikuar kohë pas kohe për të reflektuar ndryshimet në teknologji dhe strukturat industriale. Kështu, klasifikimi i aktiviteteve në Komunitet ka evoluar si më poshtë:

- a. Ndërmjet viteve 1961 dhe 1963 ishte zhvilluar Klasifikimi i industrisë në Komunitetin Europian. Klasifikimi origjinal në 1961 ishte me 3 nivele. Versioni i rishikuar në 1963 kishte nënseksione më të detajuara. NICE mbulon industrinë e nxjerrjes, energjisë, përpunimit dhe ndërtimit.
- b. Në vitin 1965, klasifikimi NCE (klasifikimi i tregtisë në vende të Komunitetit) ishte përpiluar të mbulonte të gjithë aktivitetet tregtare.
- c. Në vitin 1967 ishte përpiluar një klasifikim për shërbimet duke pasuar me një për bujqësinë, bashkë në Ndarje kufi.
- d. Përfundimisht në 1970 u përpilua NACE (Klasifikimi Industrial i Përgjithshëm për të gjitha aktivitetet ekonomike). Pamvarësisht nga emri, ky klasifikim mbulon të gjithë sferën e aktivitetit ekonomik.

Por NACE e 1970 nuk ishte mbështetur me legjislacion, të dhënat ishin grumbulluar shpesh në varësi të klasifikimeve kombëtare dhe atëhere transformoheshin në një format NACE sipas kuptimit të një çelësi kthimi. Kjo metodë nuk ofronte të dhëna për të mundësuar krahasueshmëri të kënaqshme.

Gjithashtu, meqenëse NACE 1970 nuk ishte zhvilluar nga një skemë ndërkombëtare e organizuar, kjo ofron një krahasueshmëri të pamjaftueshme me klasifikimet e tjera të aktiviteteve ekonomike.

## **II. Struktura e NACE Rev.1**

### **II.a. Prejardhja nga ISIC Rev.3**

20. Puna për revizionimin filloi në 1986 kur Eurostati krijoi një mbremje pune me Shtetet Anetare të ngarkuara në projekt. Detyra e parë ishte të ndërtohej se sa larg NACE e revizionuar mund të harmonizohej me ISIC Rev.3. Opsionet janë konsideruar të renditura nga adoptimi i plotë i ISIC Rev.3 pa asnjë ndryshim tek një disgregim i mëtejshëm tek një nivel i pestë apo i gjashtë. Kjo ishte shumë shpejt e evidente që pjesa e madhe e ISIC Rev.3 ishte insuficentalisht e disagregueshme për të paraqitur dhe monitoruar ekonomitë kombëtare evropiane dhe që disgregimi i mëtejshëm ishte i nevojshëm. Në anën tjetër, në një nivel i pestë apo i gjashtë i klasifikimit ishte për të adoptuar në nivelin evropian dhe shtetet anetare deshironin një detajim më të madh në klasifikimet e tyre kombëtare, kjo mund të lejonte një kod të shtatë apo të tetë shifror në klasifikimet e tyre kombëtare.

Përfundimi ishte që grupet e punës adoptuan një kompromis dhe për rrejdhojë tiparet kryesore të klasifikimit janë :

- (a) niveli më i ulët në NACE përmban 4 nivele
- (b) niveli i parë i ISIC Rev.3 (seksionet) është personifikuar në NACE Rev.1 me një kod alfabetik, nga A tek Q dhe është disgregim i mëtejshëm në disa hapësira Brenda nënseksioneve të shënuar me një kod alfabetik dy shifror.
- (c) Niveli i dytë i ISIC Rev.3 (ndarja) është përfshirë në NACE pa asnjë ndryshim.
- (d) Nivelet e tretë dhe të katërt (grupet dhe klasat) janë nëndarë për të reflektuar nevojat evropiane, çdo artikull 3 apo 4 shifror në NACE Rev.1 është i gatshëm të jetë agreguar në nivelet 3 dhe 4 të ISIC Rev.3 nga e cila ato kanë ardhur.

Vënia në dukje e ndryshimeve në sistemet e kodimit, kodet e NACE Rev.1 përfshijnë një ndalesë të plotë ndërmjet nivelit të dytë dhe të tretë. Gjithashtu në ISIC, rev 3 niveli i « 9 » gjithmonë

sinjifikon “të tjerë », ndërsa në NACE Rev.1, “9” është përdorur në të njëjtën rrugë si nivelet e tjera, në drejtim të sigurimit të më shumë nënseksioneve.

## II.b. Rregullimet për të takuar nevojat e Unionit European

Grupit të punës ju dha disa kohë për të diskutuar disagregimet e nivelit të tretë dhe të katër të NACE Rev.1 dhe eventualisht janë shfaqur kompromiset e mëposhtme, të cilat mund të jenë konsideruar si një version European i ISIC Rev.3 e cila ka qenë ekstentivisht i zmadhuar :

ISIC Rev.3 dhe NACE Rev.1

	ISIC Rev.3		NACE Rev.1	
17	Seksione	17	Seksione	Germë nga A në Q
-		31	Nenseksione	Kod alfabetik nivel 2 shifror
60	Ndarje	60	Ndarje	Kod 2 shifror(01-99)
159	Grupe	222	Grupe	Kod 3 shifror (01.1- 99.0)
292	Klasa	503	Klasa	Kod 4 shifror (01.11- 99.00)

Grupi i punës tregoi vëmendje në strukturën e ISIC Rev.3 veçanërisht në Seksionin G (tregti me shumicë dhe pakicë);

## II.d Aktivitete të përshkruara sipas produkteve

Çdo nivel i një klasifikimi të aktiviteteve ekonomike mund të përshkruhet përgjithësisht sipas karakteristikave të prodhimit të mallrave dhe shërbimeve. Megjithatë gjithmonë është e nevojshme të ketë lidhje me përshkrimin e aktivitetit, pasi ka raste që klasifikimi i aktivitetit bëhet bazuar në procesin e prodhimit ose të lëndës së parë sesa në bazë të produktit.

Në strukturimin e NACE Rev.1 përcaktimi ndërmjet aktiviteteve tregtar dhe jo-tregtar nuk është kriter, megjithëse kjo ka qenë kriter në NACE 1970. Megjithatë këtu janë disa klasa në NACE Rev.1 të cilat normalisht janë jotregtare (psh klasat e ndarjes 75), atje janë ndarje të tjera të cilat përcaktojnë aktivitetet që janë zbatuar zakonisht bashkë tregtare dhe jotregtare.

Një sistem i klasifikimit të aktivitetit është i varur nga adoptimi i përshkrimeve të pranueshme të aktiviteteve respektive dhe nga njësitë statistikore në të cilat këto aktivitete janë vendosur.

Në një aktivitet mbahen parasysh kombinimi i paisjeve, punës, teknikat e përpunimit, informacioni në rrjet dhe produktet, orjentuar për të krijuar mallra dhe shërbime specifike. Një aktivitet karakterizohet sipas hyrjes së produkteve (mallra dhe shërbime), një proces prodhimi dhe realizim të produkteve.

Në praktikë shumica e njësive të prodhimit kanë karakter prodhimi jo të thjeshtë. Identifikimi i “aktivitetit kryesor” është domosdoshmëri në përcaktimin e njësive ekonomike me kode të përshtatshme të vecantë të NACE Rev.1.

Aktiviteti kryesor identifikohet me metodën e “rendit zbritës” si aktiviteti që jep më shumë kontribut në vlerën e shtuar të përgjithëshme të ndërmarrjes. Kjo nuk do të thotë që aktiviteti kryesor i një ndërmarrjeje i përcaktuar në këtë mënyrë të përfaqësojë 50% ose më shumë të vlerës së shtuar të përgjithëshme të kësaj ndërmarrjeje.

Një aktivitet sekondar është çdo lloj aktiviteti tjetër i njësisë e cila prodhon mallra dhe shërbime.

Aktivitetet kryesore dhe ndihmëse përgjithësisht realizohen me ndihmën e disa aktiviteteve ndihmëse si llogaria, transporti, magazinim, blerje, shitje me proporcion, riparim dhe mirëmbajtje, etj.

### **III.c Rregullat për klasifikimin e njësive statistikore:**

Njësitë e përfshira në rregjistrat statistikore janë të klasifikuara sipas NACE Rev.1. Interpretimi i NACE është ndihmuar nga edicionet e notave shpjeguese, vendimet e komitetit të drejtimit të NACE Rev.1, tabela korrespondence, CPC, CPA, HS, CN, etj.

Çdo njësi është klasifikuar mbi bazë të aktiviteteve të zhvilluara në të si edhe duke patur parasysh në raste të vecanta lidhjet që kjo njësi mund të ketë me njësit e tjera.

Njësitë janë klasifikuar në nivelin më të detajuar të NACE Rev.1.

Njësitë mund të klasifikohen sipas kategorive që përshkrimi më i mirë i aktivitetit të tyre, duke marrë parasysh jo vetëm strukturën e nxjerrjes, por dhe strukturën e hyrjes, duke përfshirë procesin e prodhimit.

#### **Rregullat baze të klasifikimit**

Klasifikimi i aktivitetit të një njësie është përcaktuar sipas pozicionit të NACE Rev.1 në të cilën është përfshirë aktiviteti kryesor. Aktiviteti kryesor i një njësie është aktiviteti që kontribuon më shumë në vlerën e shtuar me çmime konstante të njësisë. Ku, tek çdo nivel klase, një aktivitet llogarit më shumë se 50% të vlerës së shtuar, kjo përcakton klasifikimin e njësisë. Në të gjitha rastet e tjera rregulli i klasifikimit mund të vrojtohet. Kjo kërkon që klasifikimi të kryhet në disa faza, duke përdorur metodën nga «lart posht ».

Në praktikë shpesh nuk është e mundur të merret informacion mbi vlerën e shtuar dhe aktiviteti kryesor është përcaktuar sipas kriterëve të tjera për të marrë vlerësimin më të mirë të mundshëm i cili do të mund të sigurohej në bazë të vlerës së shtuar, siç përmendet në listën më poshtë :

Bazuar në outputet :

- Prodhimi bruto i njësisë që është atribut sipas mallrave dhe shërbimeve të cdo aktiviteti.
- Vlera e shitjeve të atyre grup produkteve që bëjnë pjesë në aktivitetin e ndërmarrjes

Bazuar në inputet:

- Pagat dhe shpërblimet sipas aktiviteteve të ndryshme.
- Punësimin në aktivitetet në varësi të raportit të njerëzve të zënë me punë në aktivitete të ndryshme të njësisë.

### Metoda nga "Iart – poshtë"

II. Identifikimi i aktivitetit kryesor të një njësie referuese bëhet duke përdorur metodën nga Iart-poshtë - dmth në rastet kur ndërmarrja kryen më shumë se një aktivitet gjykimi se nga aktivitetet cili është kryesori me anë të njërit prej treguesve të mësipërm, bëhet duke u nisur në nivel të përmbledhur nga seksioni, grupi, ndarja, klasa përkatëse.

Le ta shpjegojmë këtë me një shembull të thjeshtë, ku një ndërmarrje kryen disa aktivitete, dhe tregues bazë për përcaktimin e aktivitetit kryesor është treguesi i shitjeve gjatë një periudhe 12 mujore.

Një ndërmarrje mund të zbatojë aktivitetet e mëposhtme:

Seksioni	Nëseksioni	Klasa	Përshkrimi i klasës	Vlera e shitjeve (%)
D		28	Fabrikimi i fuçive metalike	7
		29	Fabrikimi i traktorëve	8
		29.41	Fabrikimi i veglave manuale	3
		29.53	Fabrikimi i makinerive për ind. ushqimore, pije dhe duhan	21
		29.55	Fabrikimi i makinave për prodhimin e letrës dhe kartonit	8
	34	34.30	Fabrikimi i pjesëve dhe aksesorëve të mjeteve të transportit	5
G	51	51.14	Ndërmjetësimi në tregtinë e makinave, paisjeve industriale	7
		51.88	Tregti me shumicë e paisjeve bujqësore	28
K		74.20	Aktivitete të arkitekturës dhe inxhinierisë	13

**Aktiviteti ekonomik është përcaktuar si më poshtë:**

#### I. Përcaktimi i seksionit :

Seksionet	Përshkrimi	Vlera e shitjeve (%)
D	Industria përpunuese	52
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve të transportit	35
K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qera dhe shërbime për ndërmarrjet	13

Sic, shikohet nga tabela e mësipërme, seksioni D ka peshën më të madhe 52% (7+8+3+21+8+5).

#### II. Përcaktimi i ndarjes:

Ndarja	Përshkrimi	Vlera e shitjeve (%)
--------	------------	----------------------



28	Punimi i metaleve	7
29	Fabrikimi i makinave dhe paisjeve	40
34	Fabrikimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëm rimorkiove	5

Ndarja kryesore është 29 e cila zë 40% të Shitjeve.

### III. Përcaktimi i grupit

Grupi	Përshkrimi	Vlera e shitjeve (%)
29.3	Fabrikimi i makinave bujqësore	8
29.4	Fabrikimi i veglave dhe makinave-instrumenta	3
29.5	Fabrikimi i makinave me përdorim specifik	29

Grupi kryesor është 29.5.

### IV. Përcaktimi i klasës

Klasa	Përshkrimi	Vlera e shitjeve (%)
29.53	<b>Fabrikimi i makinave për industrinë ushqimore, pije dhe duhan</b>	21
29.55	Fabrikimi i makinave për prodhimin e letrës dhe kartonit	8

Aktiviteti kryesor është “**29.53 Fabrikimi i makinave për industrinë ushqimore, pijet dhe duhanin**”, pamvarësisht se klasa me vlerën më të lartë të shitjeve është “51.88 Tregtia e makinerive bujqësore dhe aksesorëve, përfshirë traktorët”.

## II. Identifikimi i ndërmarrjes duke përdorur si tregues numrin e të punësuarve

Le të shpjegojmë me një shembull të thjeshtë, rastin kur një njësi, kryen tre aktivitete të integruara tek njëra tjetra në të njëjtën kohë:

1. Aktiviteti A zë 30% të numrit të punësuarve
2. Aktiviteti B zë 30% të numrit të punësuarve
3. Aktiviteti C zë 40% të numrit të punësuarve

Po qe se A integrohet tek B me 15%, atëhere gjendja ndryshon:

1. Aktiviteti A zë 15% të nr. të punësuarve
2. Aktiviteti B zë 45% te nr. të punësuarve
3. Aktiviteti C zë 40% të nr. të punësuarve

Pra, aktiviteti A që është integruar në B përllëgaritet vetëm për pjesën e pintegruar, për 15%. Ndërsa aktivitetit B i shtohet pjesa prej 15% dhe rezulton 45% ( 30%+15%). Në këto kushte aktiviteti B është aktiviteti kryesor i ndërmarrjes.

Por këtu duhet të kemi përsëri parasysh, se në këtë rregull bëhen disa përjashtime, psh nqse nxjerrja e verës bëhet në të njëjtin vend ku nxirret rrushi, atëhere aktiviteti i prodhimit të verës nuk përfshihet në industrinë ushqimore po në bujqësi.

Po kështu dhe nxjerrja dhe përpunimi i gurit.

Kur një njësi shet me shumicë apo pakicë prodhimet e veta nuk është në tregti por në prodhim.

Kur shitja e bukës bëhet në të njëjtin vend me prodhimin e saj, ky aktivitet përfshihet në prodhim.

### **Rregullat për aktivitete specifike**

Rregullat bazë për përcaktimin e aktivitetit kryesor të një njësie statistikore janë përcaktuar më sipër.

Megjithatë ka disa procese dhe fenomene të cilat nevojiten të përcaktojnë qartë aktivitetin kryesor për të mundësuar trajtimin e njësive ekonomike në mënyrë uniforme.

### **Integrim vertikal**

Kemi integrim vertikal të aktivitetit kur faza të ndryshme të prodhimit zbatohen në proces zinxhir nga e njëjta njësi ku prodhimi i një procesi shërben si lëndë e parë për procesin pasardhës, psh prerja e pemëve e kombinuar me sharrimin, nxjerrja e argjilës e kombinuar me prodhimin e tullave, prodhimi i fijeve sintetike kombinuar me endjen e pëlhurave etj.

Një njësi me integrim vertikal lidhet zinxhir me aktivitetet që mundet përgjithësisht të jetë e klasifikuar sipas aktivitetit që kontribuon më shumë në vlerën e shtuar të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara. Megjithatë për arsye praktike të vlefshmërisë së të dhënave, është shpesh herë produkti final përcaktuesi.

### **Integrim horizontal**

Njësitë ku aktivitete të ndryshme zbatohen njëherësh duke përdorur të njëjtët faktorë të prodhimit, por që nuk mund të jenë të ndara brenda një njësie statistikore (psh, prodhimi i produkteve të furrës kombinuar me prodhimin e çokollatave) klasifikohen sipas produktit përfundimtar.

### **Aktivitete të ndërmarrja mbi bazë ndërmjetësimi ose kontrate**

Njësitë që zbatojnë një aktivitet mbi bazë ndërmjetësimi ose kontrate janë klasifikuar me njësitë që prodhojnë të njëjtat mallra ose shërbime për llogari të tyre. Këto janë dy tipe:

**Puna në plane**, ku kontraktori siguron subkontraktorët me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara për prodhimin ose produktet që ai ka porositur. Kjo situatë gjendet kryesisht në sektorët e punimit të metalit si farkëtim, prerje, stampim dhe fonderi.

**Puna e kryer mbi kërkesat**, ku subkontraktoret zbatojnë një proces special mbi një objekt të siguar nga kontraktori. Objekti mund të jetë qoftë një lëndë e parë ose një pjesë mekanike e përfunduar. Proçesi i punës mund të jetë një përpunim i mëtejshëm i metaleve (kromimi) ose përgatitja e frutave për konservë, etj

## **Porositësit**

Porositës janë njësi të cilat shesin nën emrin e tyre mallrat dhe shërbimet që kanë porositur, por këto janë të prodhuara nga të tjerë. Këto njësi janë klasifikuar në seksionin G, (tregti me shumicë dhe pakicë) përveç rasteve kur ato luajnë një rol domethënës në përcaktimin dhe zhvillimin e produktit (psh dizenjimi) dhe merr riskun e bashkimit me prodhimin (psh materialet e veta nga i cili është bërë produkti), në këto raste ato janë klasifikuar në prodhimin e produktit.

## **Instalimi dhe montimi ne vend**

Njësitë kryesisht të zëna në instalimin ose montimin e disa artikujve ose paisjeve të domosdoshme për një ndërtesë që ajo të funksionojë, janë klasifikuar në Ndërtim, (ndarja 45). Janë përfshirë këtu artikujt si paisjet ngrohëse dhe ventiluese, ashensorët dhe ventilatorët, furnizimin me energji, gaz dhe ujë, dritaret, dyert etj.

Instalimi dhe montimi normalisht përfshijnë proceset deri në vënien në punë të pajisjes ose shërbimit duke garantuar funksionimin në vend pa probleme të tij, si edhe udhëzimet për një përdorim të mirë dhe mirëmbajtjen në kohë.

Instalimet që janë si përmbushëse të një shërbimi të rastësishëm për shitjen e automjeteve është një aktivitet i lidhur (psh instalimi i paisjeve elektrike shtëpiake tek blerësi).

## **Riparime dhe mirëmbajtje**

Njësitë që meren me riparime, mirëmbajtje ose rikonstruksione, janë klasifikuar në të njëjtën klasë si njësitë që prodhon atë, përveç rasteve të mëposhtme:

- njësitë që riparojnë dhe mirëmbajnë automjetet dhe motoçikletat janë klasifikuar respektivisht, në grupet 50.2 dhe 50.4.
- njësitë që riparojnë mallra personale dhe shtëpiake janë klasifikuar në grupin 52.7
- njësitë që riparojnë dhe mirëmbajnë paisjet e ngrohjes qendrore të banesave janë klasifikuar në 45.33
- njësitë që riparojnë dhe mirëmbajnë kompjuterat dhe paisjet e zyrave janë klasifikuar në grupin 72.5.

## **Rregulla dhe definicione të seksioneve specifike**

### **Seksioni G – Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i makinave, motocikletave dhe mallrave personale dhe shtëpiake.**

Në NACE Rev.1, tregtia me shumicë dhe pakicë përfshin të gjitha njësitë ku aktiviteti kryesor ekonomik përfshin blerjen e mallrave të transportueshme, dhe rishitjen e tyre dhe/ose me veprimin e një agjenti ndërmjet shitësit dhe blerësit të mallrave. Disa mallra janë vetëm subjekt i trajtimit apo paketimit; pa pësuar ndonjë ndryshim të dukshëm.

Tregtia me shumicë dhe pakicë përmban jo vetëm tregtinë direkte ndërmjet dy palëve, por edhe atë për llogari të një ose më shumë të tretëve. Është e rëndësishme që aktiviteti kryesor të jetë tregtimi i produkteve që nuk kanë pësuar ndryshim të ndjeshëm nga shitësi.

Në tregti përfshihen edhe shërbimet që lidhen me shitjen e produkteve si për shembull dorëzimi dhe instalimi i pajisjeve elektrike.

## Tregtia me pakice

Grupet NACE Rev.1 të tregtisë me pakicë përfshijnë të gjitha njësitë aktiviteti ekonomik i të cilave është kryesisht shitja e mallrave ndaj kryesisht familjeve pë llogari tëvet ose për llogari të të tretëe.

Tregtia me pakicë kryhet në mjedise të përshtatshëm për të gjithë. Ekzistojnë edhe forma të tjera të shitjes me pakicë, për shembull shitja me korespondencë dhe telefon, tregti me mjete të lëvizëshme në vende të përkohshme ose në magazina.

Tregtia me pakice klasifikohet në përgjithësi sipas tipit të pikës së shitjes. Shitja me pakicë e mallrave të tjerë në njësi të specializuara ndahet më tej në bazë të gamës së produkteve të shitur.

Njësitë që kryejnë aktivitete të ndryshme tregtare me pakicë pa ndonjë mbizotërim të veçantë klasifikohen në grupin **52.1**. Ky grup përshin klasën **52.11** për njësitë që shesin kryesisht mallra ushqimore, pije dhe duhan dhe klasën **52.12** për njësitë që tregtojnë kryesisht grupin tjetër të mallrave.

Njësitë, aktiviteti kryesor i të cilave bazuar në vlerën e shtuar (ose ndonjë tregues tjetër të përshtatshëm) është shitja me pakicë në shitore, duhen klasifikuar në njërin prej klasave 52.11-52.50. **Me përcaktimin e gamës së produkteve të shitur nga njësitë e vecanta klasifikimi bëhet në bazë të rregullave të mëposhtëm:**

1. Nëse produktet e shitur përfshihen në një klasë të vetme NACE Rev.1 atëhere natyrisht klasifikimi bëhet direkt në atë klasë.

Shembull:

Një ndërmarrje tregtare, shet vetëm pije, atëhere kjo ndërmarrje klasifikohet direkt në klasën **52.25**.

2. Nëse produktet e shitura përfshihen në disa klasa të NACE Rev.1 (kufiri më i ulët i përqindjes për çdo klasë është 5%) duhet përcaktuar nëse njëra nga klasat përfaqëson 50 % ose më shumë të vlerës së shtuar (ose të një treguesi tjetër të përshtatshëm). Në këtë rast njësia duhet klasifikuar në atë klasë.

Shembull: a) <b>52.41-20%</b>	b) <b>52.21-10%</b>
<b>52.42-30%</b>	<b>52.24-10%</b>
<b>52.43-50%</b>	<b>52.25-10%</b>
	<b>52.33-15%</b>
	<b>52.41-55%</b>

në rastin e parë njësia klasifikohet në **52.43**

në rastin e dytë njësia klasifikohet në **52.41**

3. Nëse produktet e shitur përfshihen në disa klasa të NACE Rev.1, nga të cilat asnjëra nuk ka një përqindje baraz ose më të madhe se 50% të vlerës së shtuar, dhe ku sejcila ka një përqindje më të madhe se 5% të vlerës së shtuar duhet bërë një analizë më e thellë për një klasifikim të përshtatshëm, dhe kjo varet nga numri i klasave të NACE që do të trajtohen.

4. Nëse produktet e shitur klasifikohen deri në katër klasa të NACE Rev.1 (grupet 52.2, 52.3 dhe 52.4), asnjëra prej të cilave nuk përfaqëson 50% e më shumë të vlerës së shtuar dhe ku sejcila ka një përqindje më të madhe se 5% të vlerës së shtuar, por duhet patjetër të kemi një klasifikim të

përshtatshëm të shitores, bazuar në llojin e produktit të shitur. Për këtë duhet patjetër të përqëndrohemi tek aktiviteti për të përcaktuar atë kryesor duke u bazuar në një tregues tjetër të përshtatshëm që na vjen në ndihmë. Në këtë rast mund të marrim bazë grupin brenda të cilit ndodhet klasa që është përcaktuese për aktivitetin kryesor.

Shembull: **52.44-45%**  
**52.25-30%**  
**52.27-25**

Duke qenë se kemi një gjendje të diskutueshme për përcaktimin e aktivitetit **52.25+52.27 =55%** që është **tregti ushqimor**, dhe **52.44 shitje mobiljesh** është **45%**, atëhere kalojmë më tej në analizën tre shifrore të aktivitetit dhe kemi dy aktivitete për trajtim (në bazë të produktit të shitur) **52.2 dhe 52.4**

Pas këtij grupimi njësia klasifikohet në **52.2** dhe brenda këtij grupimi është klasa **52.25 me 30%** të vlerës së shtuar ajo të cilës i përket klasifikimi i kësaj njësie tregtare.

5. Nëse produktet e shitur përfshihen në pesë e më shumë klasa të grupeve **52.2,52.3, dhe 52.4** (që janë tregti me pakicë në dyqane të specializuar) secila prej tyre përfaqson më shumë se 5% të vlerës së shtuar ndërsa asnjëra nuk arrin ose kalon 50%, atëhere duke mos pasur një tregues të qartë për këtë aktivitet arrihet në konkluzionin se kemi të bëjmë me një aktivitet të tipit supermarket i cili klasifikohet në **52.1**. Nëse brenda këtij grupi produktet ushqimore, pije dhe duhan përfaqsojnë të paktën 35% të treguesit të zgjedhur (vlerës së shtuar ose ndonjë treguesi tjetër) atëhere njësia klasifikohet në **52.11** të NACE Rev.1. Në të gjithë rastet e tjera klasifikimi bëhet në klasën **52.12**.

**Shënim:** Rregullat e përcaktimit të aktivitetit kryesor bazohen gjithmonë në tregtinë me pakicë që kryen njësia. Nëse një njësi përveç tregtisë me pakicë kryen një aktivitet tjetër sekondar i cili mund të jetë shërbim ose prodhim përcaktimi i klasës së përshtatshme të grupit 52 do të varet vetëm nga lloji i aktivitetit tregtar me pakicë që kryen kjo njësi.

## **Seksioni L Administrata publike**

Kriteri i klasifikimit i përdorur në sektorin privat përdoret për analogji edhe në administratën shtetërore. Por jo e gjithë administrata shtetërore është e klasifikuar në seksionin L. Njësitë që zbatojnë aktivitetet e tyre në nivel kombëtar, rajonal apo lokal janë specifikisht të vendosur në hapësira të tjera të NACE Rev.1 janë klasifikuar në sektorët përkatës, psh (arsimi në seksionin M dhe shëndetsia në seksionin N) dhe jo në seksionin L ku gjejmë “Administratën publike dhe mbrojtjen: sigurimin shoqëror të detyrueshëm”.

Shembull:

Një institucion i arsimit të lartë i administruar nga njësi qendrore apo lokale është klasifikuar në 80.30, ndërsa një spital i administruar edhe ai nga një njësi qendrore apo lokale është klasifikuar në 85.11..

## **Ndarja 95 Familjet private me persona të punësuar**

Vëmendje është kushtuar në faktin që klasa 95.00 përfshin vetëm aktivitetet e familjeve private që punësojnë personel shtëpiak. Rezultat i këtij aktiviteti është prodhim sipas sistemit të llogarive kombëtare dhe për këtë qëllim dhe për arsye vrojtimi kjo është përfshirë në NACE Rev.1. Personeli shtëpiak në vetvete nuk klasifikohet në 95.00.

## **Ndarja 96 dhe 97**

Bazuar ne ISIC Rev.3.1, jane shtuar dy ndarje te reja ne NACE Rev.1.1, ndaraj 96 ... me qe llim te mbuloje te gjithe aktivitetet e prodhimit, .....

### **III.d Ndryshimet në klasifikimin e njësive**

Njësi të ndryshme në mënyrë frekvente ndryshojnë aktivitetin e tyre kryesor njëherë ose gradualisht në periudha kohe. Aktiviteti kryesor mund të ndryshojë brenda një viti nga një periudhë statistikore në një tjetër, kjo ndodh për arsye të faktorëve sezonale ose për arsye të vendimeve të drejtuesve për të ndryshuar modelin e prodhimit. Në cdo rast këto janë ndryshime të befasishme në bilancin e aktiviteteve. Gjithashtu, një ndryshim në modelin e prodhimit ose shitjes mund të transportohet gradualisht në vite të vecanta. Ndërsa të gjitha këto raste konsiderohen në klasifikimin e njësisë së ndryshuar, gjithashtu ndryshimet frekvente ndryshojnë statistikën drejt nivelit të interpretimit i cili është mjaft i vështirë.

Për të shmangur ndryshimet frekvente është i domosdoshëm “rregulli i stabilitetit”. Pa një rregull të tillë ku të mund të jenë të qarta ndryshimet në demografinë e ndërmarrjeve të regjistrit të ndërmarrjeve të cilat mund të jenë jo më shumë se një produkt statistikor. Duke punuar sipas rregullit është që aktivitetet sekondare do mund të përjashtojnë aktivitetet në t cilin njësia është klasifikuar për dy vjet përpara se klasifikimi është ndryshuar.

Ndryshime në klasifikimin e njësisë për qllime statistikore bëhen jo mw shumë se njëherë në vit, gjithashtu datën e caktuar ose informacioni të bëhet i vlefshëm ; ndryshimet shumë të shpeshta sjellin rezultate te pakrahasueshme ndërmjet statistikave afatshkurtra (muajore apo tremujore) dhe statistikave afatgjata.

#### **Definicione**

Më poshtë jepet përshkrimi i disa prej termave të përdorura në NACE Rev.1.1.

Qëllimi i dhënies së këtyre definicioneve është të ndihmojë përdoruesit e NACE Rev.1.1 të interpretojnë korrekt atë.

**Sipas –produkteve** - E veçanta sipas-produkteve është një produkt teknologjikisht i lidhur me prodhimin e produkteve të tjera në të njëtin grup, por i cili nuk është prodhuar nga ndonjë grup tjetër (psh melasa është e lidhur me prodhimin e sheqerit). Sipas produkteve janë përdorur vetëm si inpute për përpunimin e produkteve të tjera.

Normalja sipas produkteve – është një produkt teknologjikisht i lidhur me prodhimin e grupeve të tjera, por i cili është prodhuar në grupe të vecanta. (psh hidrogjeni i prodhuar gjatë rafinimit të naftës është teknologjikisht i lidhur me atë të prodhuar në përpunimin e petrokimise dhe karbonizimin e qymyrit dhe identik me atë të prodhuar në grup produktet kimike bazë.

**Të mirat kapitale** - Të mirat kapitale janë mallrat, të tjera përveç lëndës së parë dhe lëndës djegëse, të përdurura për prodhimin e mallrave dhe/ose shërbimeve të tjera. Ato përfshijnë ndërtesat e fabrikave, makineritë, lokomotivat, kamionët dhe traktorët. Toka zakonisht nuk konsiderohet si mall kapital.

**Prodhimi** – është një aktivitet që materializohet në një produkt përfundimtar. Ky emërtim përdoret gjerësisht në të tre sektorët e mëdhenj pra mbulon të gjithë sektorët e veprimtarive ekonomike. Kështu termi prodhim nuk përdoret vetëm për sektorin e bujqësisë apo të industrisë nxjerrëse dhe atë përpunuese, por dhe për sektorin e shërbimeve. Emërtime me specifike mund

të përdoren për të precizuar prodhimin: transformimi, fabrikimi, shërbimi.etj, në funksion të klasës përkatëse të veprimtarisë ekonomike.

**Transformimi** –Eshtë një process me anë të të cilit arihet që të ndryshohet forma, natyra apo përbërja e lëndëve të para apo të produkteve gjysëm të gatëshme për të përfutuar produkte te rinj.

**Produkti** – Eshtë rezultat i një aktiviteti ekonomik. Ky emërtim përdoret si për mallrat ashtu dhe për shërbimet.

**Trajtimi**- Eshtë një process që përdoret për të mbrojtur disa produkte, për të ruajtur cilesitë e tyre, apo për të paralajmëruar dëmtimet që mund të vijnë nga përdorimi i tyre. Mund të përmendim trajtimin e kulturave, të drurit, të metaleve, të mbetjeve.

**Produkte të ndërmjetëm** - Janë produkte që do ti nënshtrohen një përpunimi të mëtejshëm.

**PJESA E DYTE**  
**AKTE LIGJORE**



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
Këshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 327 datë 18.7.1994

Për

MIRATIMIN E ZBATIMIT TE NOMENKLATURES TE VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

Në zbatim të ligjit Nr.7687 datë 16.3.1993 "Për statistikën", me propozimin e Institutit të Statistikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Zbatimi i nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike

- 1.Miratohet zbatimi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike që i bashkangjitet këtij vendimi.
- 2.Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike zbatohet për mbledhjen, klasifikimin, dhe publikimin e të dhënave zyrtare.
- 3.Nomenklatura e veprimtarive ekonomike zbatohet në mënyrë unike nga të gjitha ministratë, institucionet e tjera qëndrore, organet e pushtetit lokal dhe personat juridikë e fizikë që ushtrojnë veprimtari ekonomike, për sistemin informatik të tyre, për klasifikime të përmbledhura, tekste zyrtare dhe punime e studime të ndryshme statistikore.

## II. Komisioni i Nomenklaturave të Veprimtarive Ekonomike

1. Krijohet komisioni i nomenklaturave për të drejtuar punën për përshtatjen dhe zbatimin e nomenklaturave.

2. Komisioni i nomenklaturave përbëhet nga:

- Drejtori i Institutit të Statistikës
- Përfaqësues të Institutit të Statistikës
- Përfaqësues nga secila Drejtori Ekonomike e Ministrive
- Përfaqësues i Bankës së Shqipërisë
- Përfaqësues i Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë
- Përfaqësues i Organizatave kryesore Sindikaliste.
- Përfaqësues të organizatave kryesore ekonomike private.

3. Kryetari i komisionit të nomenklaturave është Drejtori i Institutit të Statistikës, i cili miraton përmbajtjen dhe numrin e anëtarëve të këtij komisioni.

## III. Detyrat e komisionit të nomenklaturave

Komisioni i nomenklaturave kryen:

1. Përshtatjen dhe rishikimin e nomenklaturës së veprimtarive ekonomike ndërkombëtare dhe atyre të ngjashme me të, në nomenklatura të Shqipërisë:

- Duke patur parasysh specifikat dhe ndryshimet e veprimtarive ekonomike të ushtruar në vendin tone.

- Duke patur parasysh përmirësimet e mundëshme të nomenklaturës ndërkombëtare të veprimtarive ekonomike dhe atyre të ngjashme me të.

2. Miratimin e udhëzimeve përkatëse të nomenklaturës të veprimtarive ekonomike dhe atyre të ngjashme me të.

IV. Periudha e provës për vënien në zbatim të Nomenklaturës të Veprimtarive Ekonomike të jetë 6-mujori i dytë i vitit 1994.

Ky vendim hyn në fuqi me 1.1.1995 dhe të zbatohet për provë gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 1994.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

ALEKSANDER MEKSI

**PJESA E TRETE**

**STRUKTURA**

**NVE REV 1.1**

**SEKSIONI A BUJQËSIA, GJUETIA DHE SILVIKULTURA****01 Bujqësia, gjuetia dhe shërbime plotësuese**

01.1	Mbjellja e drithrave, perimeve, florikultura	011
01.11	Mbjellja e drithërave dhe të kulturave të tjera	0111
01.12	Mbjellja e perimeve, specialiteteve të kopshtarisë, lule dhe prodhime të fidanishteve	0112
01.13	Mbjellja e frutave, e frutave me levozhgë, farërave për përgatitjen e pijeve dhe erëzave	0113
01.2	Blegtoria	012
01.21	Rritja e gjedhëve, prodhimi i qumështit në ferma	0121
01.22	Rritja e të dhirtave, të leshta dhe njethundrakëve (kafshëve të punës)	0121
01.23	Rritja e derrave	0122
01.24	Rritja e shpendëve dhe prodhimi i vezëve	0122
01.25	Rritja e kafshëve të tjera (lepujve, bletëve, krimb mëndafshi etj)	0122
01.3	Mbjellja e bimëve bujqësore shoqëruar me rritjen e bagëtive (aktivitet i përzier)	013
01.30	Mbjellja e bimëve bujqësore shoqëruar me rritjen e bagëtive (aktivitet i përzier)	0130
01.4	Shërbime plotësuese në bujqësi dhe zootekni përveç shërbimeve veterinarë	014
01.41	Shërbime plotësuese në bujqësi	01.40
01.42	Shërbime plotësuese në blegtori përveç aktiviteteve veterinarë	
01.5	Gjuetia dhe kapja e kafshëve të egra për rritje dhe shtim, përfshirë shërbimet që lidhen me to.	015
01.50	Gjuetia dhe kapja e kafshëve të egra për rritje dhe shtim, përfshirë shërbimet që lidhen me to.	0150

**02 Silvikultura, shfrytëzimi i pyjeve, shërbime plotësuese**

02.0	Silvikultura, shfrytëzimi i pyjeve, shërbime plotësuese	020
02.01	Silvikultura dhe shfrytëzimi i pyjeve	0200
02.02	Shërbime plotësuese në silvikulturë dhe në shfrytëzimin e pyjeve	0200

**SEKSIONI B PESHKIMI****05 Peshkimi, kultivimi i peshkut dhe shërbimet në lidhje me peshkimin**

05.0	Peshkimi, kultivimi i peshkut, kulturat ujore, shërbime plotësuese në peshkim	050
------	---	-----

05.01	Peshkimi	0500
05.02	Kultivimi i peshkut dhe gjallesave ujore	0500
05.03	Shërbime plotësuese në peshkim	0500

## **SEKSIONI C      INDUSTRIA NXJERRËSE**

### **NËNSEKSIONI CANXJERRJA E MINERALEVE ENERJITIKE**

<b>10</b>	<b>Nxjerrja e qymyrgurit dhe e linjiteve; nxjerrja e torfës</b>	
10.1	Nxjerrja dhe aglomerimi i qymyrgurit	
101		
10.10	Nxjerrja dhe aglomerimi i qymyrgurit	
1010		
10.2	Nxjerrja dhe aglomerimi i linjiteve	102
10.20	Nxjerrja dhe aglomerimi i linjiteve	1020
10.3	Nxjerrja dhe aglomerimi i shtresave të varfra të mineralit	103
10.30	Nxjerrja dhe aglomerimi i shtresave të varfra të mineralit	1030
<b>11</b>	<b>Nxjerrja e naftës bruto, gazit natyror, shërbimeve plotësuese në nxjerrjen e naftës dhe të gazit, përveç studimeve gjeologjike</b>	
11.1	Nxjerrja e naftës bruto dhe e gazit natyror	111
11.10	Nxjerrja e naftës bruto, gazit natyror, rërës dhe shistit bituminoz	1110
11.2	Shërbime plotësuese në nxjerrjen e naftës dhe të gazit, përveç studimeve gjeologjike	112
11.20	Shërbime plotësuese në nxjerrjen e naftës dhe të gazit, përveç studimeve gjeologjike	1120
<b>12</b>	<b>Nxjerrja e mineralit të uraniumit dhe toriumit</b>	
12.0	Nxjerrja e mineralit të uraniumit dhe të toriumit	112
12.00	Nxjerrja e mineralit të uraniumit dhe të toriumit	1120

### **NËNSEKSIONI CB NXJERRJA E MINERALEVE JO ENERJITIKE**

<b>13</b>	<b>Nxjerrja e mineraleve metalike</b>	
13.1	Nxjerrja e mineralit të hekurit	131
13.10	Nxjerrja e mineralit të hekurit	1310

13.2	Nxjerrja e mineralit të metaleve jo-ferromanjetike (alumin, bakër, krom etj) përvec uraniumit dhe toriumit	132
13.20	Nxjerrja e mineraleve metalike jo ferroke, me përjashtim të mineraleve të uraniumit dhe të toriumit	1320
<b>14</b>	<b>Industri të tjera nxjerrëse</b>	
14.1	Nxjerrja e gurit	141
14.11	Nxjerrja e gurit për ndërtime	1410
14.12	Nxjerrja e gurit gëlqeror, të gipsit, dhe të gëlqeres natyrore	1410
14.13	Nxjerrja e shistit argjilor	1410
14.2	Nxjerrja e zallit, rërës dhe e argjilës	141
14.21	Nxjerrja e zallit dhe e rërës	1410
14.22	Nxjerrja argjilës dhe argjilës së bardhë (kaolinë)	1410
14.3	Nxjerrja e mineraleve për industrinë kimike dhe plehrave natyrore	142
1430	Nxjerrja e mineraleve për industrinë kimike dhe plehut natyrore	1421
14.4	Prodhimi i kripës	142
14.40	Prodhimi i kripës	1422
14.5	Nxjerrja e mineraleve dhe prodhimeve të tjera të vendburimeve, të papërfshira më sipër 142	
14.50	Nxjerrja e mineraleve dhe prodhimeve të tjera të vendburimeve, të papërfshira më sipër 1429	
<b>SEKSIONI D      INDUSTRIA PËRPUNUESE</b>		
<b>NËNSEKSIONI D A INDUSTRIA USHQIMORE, E PIJEVE DHE E DUHANTIT</b>		
<b>15</b>	<b>Industria ushqimore dhe e pijeve</b>	
15.1	Prodhimi, transformimi dhe konservimi i mishit dhe i produkteve me bazë mishi	151
15.11	Prodhimi dhe ruajtja e mishit, përvec mishit të shpendëve	1511
15.12	Prodhimi dhe ruajtja e mishit të shpendëve	1511
15.13	Prodhimi i produkteve me bazë mishi të bagëtive dhe të shpendëve	1511
15.2	Përpunimi dhe konservimi i peshkut dhe i produkteve me bazë peshku	151
15.20	Përpunimi dhe konservimi i peshkut dhe i produkteve me bazë peshku	1512
15.3	Përpunimi dhe konservimi i frutave dhe perimeve	151
15.31	Përpunimi dhe konservimi i patateve (pure, niseshte patate etj)	1513
15.32	Përgatitja e lëngut të frutave dhe perimeve	1513
15.33	Transformimi e konservimi i frutave dhe perimeve	1513

15.4	Fabrikimi i vajit dhe i yndyrnave bimore dhe shtazore	151
15.41	Fabrikimi i vajit dhe i yndyrnave bruto	1514
15.42	Fabrikimi i vajit dhe i yndyrnave te rafinuara	1514
15.43	Prodhimi i margarinës dhe i produkteve ushqimore të ngjashme	1514
15.5	Industria e qumështit	152
15.51	Trajtimi higjenik, konservimi dhe transformimi i qumështit	1520
15.52	Prodhimi i akullores	1520
15.6	Prodhimi i miellit nga drithrat, zarzavatet, fabrikimi i produkteve proteinike	153
15.61	Përpunimi i drithrave	
15.62	Fabrikimi i produkteve me permbajtje amidoni	1532
15.7	Fabrikimi i produkteve për ushqimin e kafshëve	153
15.71	Fabrikimi i produkteve për ushqimin e kafshëve të fermës	1533
15.72	Fabrikimi i produkteve per ushqimin e kafshëve shtepiake	1533
15.8	Fabrikimi i produkteve te tjere ushqimore	154
15.81	Fabrikimi i bukës dhe ëmbëlsirave të freskëta	1541
15.82	Fabrikimi i biskotave e galetave dhe fabrikimi i ëmbëlsirave të konservuara	1541
15.83	Fabrikimi i sheqerit	1542
15.84	Fabrikimi i kakaos, i çokollatës, i sheqerkave dhe reçelnave	1543
15.85	Fabrikimi i brumrave ushqimore makarona, kuskus e të tjera të ngjashme	1544
15.86	Përpunimi i çajit dhe i kafesë	1549
15.87	Fabrikimi i erëzave dhe i salcave	1549
15.88	Fabrikimi i preparateve te homogjenizuar dhe te ushqimeve dietetike	1549
15.89	Fabrikimi i produkteve të tjerë ushqimore, të paklasifikuara vend tjetër	1549
15.9	Industria e pijeve	155
15.91	Fabrikimi i pijeve alkolike të distiluara	1551
15.92	Fabrikimi i alkolit etilik të fermentuar	1551
15.93	Prodhimi i veres nga rrushi (jo prodhim i vet)	1552
15.94	Prodhimi i mushtit dhe i verërave të tjera me bazë frutash	1552
15.95	Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara jo të distiluara	1552
15.96	Prodhimi i birrës	1553
15.97	Prodhimi i majasë së birrës	1553
15.98	Prodhimi i ujit mineral dhe te pijeve freskuese pa alkol	1554
<b>16</b>	<b>Industria e duhanit</b>	
16.0	Industria e duhanit	160
16.00	Industria e duhanit	1600

## NËNSEKSIONI DB INDUSTRIA TEKSTILE DHE E VESHJEVE

<b>17</b>	<b>Industria e tekstileve</b>	
17.1	Përgatitja dhe filatura e fibrave tekstile	171
17.11	Përgatitja dhe filatura e fibrave të pambukut	1711
17.12	Përgatitja dhe filatura e fibrave të leshit të lenur	1711
17.13	Përgatitja dhe filatura e fibrave të leshit të krehur	1711
17.14	Përgatitja dhe filatura e fibrave të linit	1711
17.15	Tjerrja dhe thurja e mëndafshit dhe e tekstileve artificiale ose sintetike.	1711
17.16	Fabrikimi i fillit për të qepur	1711
17.17	Përgatitje dhe filaturimi i fibrave të tjera tekstile	1711
17.2	Endja e tekstileve	171
17.21	Endja e tekstileve të pambukta	1711
17.22	Endja e stofrave të leshat-cikli i lenurrjes	1711
17.23	Endja e stofrave të leshat- cikli i krehjes	1711
17.24	Endja e pëlhurave të mëndafshat	1711
17.25	Endje të tekstileve të tjera (kërp,lin)	
17.3	Proceset përfundimtare të tekstileve (stampimi, zbardhja , ngjyrosja etj).	171
17.30	Proceset përfundimtare të tekstileve (stampimi, zbardhja, ngjyrosja etj)	1712
17.4	Fabrikimi i artikujve të konfeksionuara në tekstil, përveç veshjeve	172
17.40	Fabrikimi i artikujve tekstil të konfeksionuara, përveç veshjeve	1721
17.5	Industri të tjera tekstile	172
17.51	Fabrikimi i tapeteve dhe moketeve	1722
17.52	Fabrikimi i litareve, spangove, rrjetave	1723
17.53	Fabrikimi i pëlhurave e artikujve pa endje, përveç artikujve të veshjes	1729
17.54	Fabrikimi i artikujve të tjera tekstile (fjongo, tyl, fitile etj)	1729
17.6	Fabrikimi i tekstileve me thyesa	173
17.60	Fabrikimi i tekstileve me thyesa	1730
17.7	Fabrikimi i artikujve me thyesa	173
17.71	Fabrikimi i llojeve të ndryshme të corapeve të thurura	1730
17.72	Fabrikimi i pulovrave, jelekëve dhe artikujve të ngjashëm me thyesa	1730
<b>18</b>	<b>Industria e veshjeve dhe e gëzofëve</b>	
18.1	Fabrikimi i veshjeve me lëkurë	181
18.10	Fabrikimi i veshjeve me lëkurë	1810



18.2	Fabrikimi i veshjeve prej tekstili	181
18.21	Fabrikimi i veshjeve të punës	1810
18.22	Fabrikimi i veshjeve të jashtme	1810
18.23	Fabrikimi i veshjeve të brëndëshme	1810
18.24	Fabrikimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (doreza, kapele, shall etj)	1810
18.3	Përgatitja dhe ngjyrosja e gëzofëve. Fabrikimi i artikujve prej gëzofi	182
18.30	Përgatitja dhe ngjyrosja e gëzofëve. Fabrikimi i artikujve prej gëzofi	1820

## **NËNSEKSIONI DCINDUSTRIA E LËKURËS DHE E KËPUCËVE**

<b>19</b>	<b>Përgatitja, tanini i lëkurës, fabrikimi i artikujve të udhëtimit dhe të galanterisë, fabrikimi i pajimeve të kuajve dhe fabrikimi i këpucëve</b>	
19.1	Përgatitja dhe tanini i lëkurës	191
19.10	Përgatitja dhe tanini i lëkurës	1911
19.2	Fabrikimi i artikujve të udhëtimit, të galanterisë, dhe të pajisjeve të kuajve	191
19.20	Fabrikimi i artikujve të udhëtimit, të galanterisë, të pajisjeve të kuajve	1912
19.3	Fabrikimi i këpucëve	192
19.30	Fabrikimi i këpucëve	1920

## **NËNSEKSIONI DD PUNIMET ME DRU DHE FABRIKIMI I ARTIKUJVE PREJ DRURI**

<b>20</b>	<b>Industria e drurit dhe i artikujve me dru përveç fabrikimit të mobiljeve, shporterisë dhe të xunkthit</b>	
20.1	Sharimi dhe punimi i drurit, stazhionimi i drurit	201
20.10	Sharimi dhe punimi i drurit, stazhionimi i drurit	2010
20.2	Fabrikimi i kompesatos, rimesos, të panelave të vecanta, dhe të fibrës	202
20.20	Fabrikimi i kompesatos, rimesos, të panelave të vecanta, dhe të fibrës	2021
20.3	Fabrikimi i artikujve në dru të karpentierëve dhe të zdrukthtarisë të ndërtesave	202
20.30	Fabrikimi i artikujve në dru të karpentierëve dhe të zdrukthtarisë të ndërtesave	2022
20.4	Fabrikimi i ambllazheve prej druri	202

20.40	Fabrikimi i ambllazheve prej druri	2023
20.5	Fabrikimi i artikujve të tjerë me dru, me tapë, të shporterisë e të xunkthit	202
20.51	Fabrikimi i artikujve të tjerë me dru (bobina, artikuj guzhine prej druri, etj)	2029
20.52	Fabrikimi i artikujve prej tape, artikujve të shporterisë dhe të xunkthit	2029

**NËNSEKSIONI DE FABRIKIMI I BRUMIT TË LETRËS, I LETRËS DHE  
ARTIKUJVE PREJ LETRE; SHTYPSHKRONJA DHE BOTIMI**

**21 Fabrikimi i brumit të letrës, i letrës dhe artikujve prej letre dhe kartoni**

21.1	Fabrikimi i brumit të letrës, i letrës dhe i kartonit	210
21.11	Fabrikimi i brumit të letrës	2101
21.12	Fabrikimi i letrës dhe i kartonit	2101
21.2	Fabrikimi i artikujve prej letre dhe kartoni	210
21.21	Fabrikimi i letrës dhe i kartonit të valëzuar dhe ambllazhit me letër dhe me karton	2102
21.22	Fabrikimi i produkteve prej letre dhe kartoni për përdorim shitepiak dhe higjenosantar	2109
21.23	Fabrikimi i artikujve prej letre	2109
21.24	Fabrikimi i letrës të ngjyrosur dhe letrës për të veshur muret	2109
21.25	Fabrikimi i artikujve të tjerë me letër dhe me karton (ambllazh për vezë, etiketa etj)	2109

**22 Botimi, shtypshkronja dhe riprodhimi i suporteve të rregjistruara**

22.1	Botimi	221
22.11	Botimi i librave	2211
22.12	Botimi i gazetave	2212
22.13	Botimi i revistave dhe i periodikëve	2212
22.14	Botimi i suporteve zanore të rregjistruar	2213
22.15	Të tjera botime	2219
22.2	Shtypshkronja dhe shërbime të lidhura me shtypshkrimin	222
22.21	Shtypshkrimet e gazetave	2221
22.22	Shtypshkrime të tjera të artit grafik (katalog, libra, broshura etj)	2221
22.23	Lidhja dhe finicioni	2222
22.24	Kompozimi dhe fotogravura	2222
22.25	Aktivitetet të tjera lidhur me shtypshkrimin	2222
22.3	Riprodhimi i suporteve të rregjistruar	223
22.31	Riprodhimi i suporteve zanore të rregjistruar	2230
22.32	Riprodhimi i regjistrimeve video	2230

22.33	Riprodhimi i regjistrimeve informatike	2230
-------	--	------

## **NËNSEKSIONI DFKOKSIFIKIMI, RAFINIMI I NAFTËS, INDUSTRIA BËRTHAMORE**

<b>23</b>	<b>Koksifikimi, rafinimi i naftës, industria bërthamore</b>	
23.1	Koksifikimi	231
